

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

MIRATOHET

Kryetari

ERVIN DEMO

DETYRË PROJEKTIMI

*[Handwritten signature in blue ink]*  
 PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË ZBATIMIT



Nr.	HARTIMI I PROJEKT – ZBATIMIT PER OBJEKTIN:
1	NDERTMI I RRJETIT TE RI TE KANALIZIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA TE LAGJES UZNOV, RAJONI NR.1 DHE FSHATI DUHANAS, BASHKIA BERAT



## Libëra Permbledhese

1. QELLIMI:.....	3
2. PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES:.....	4
2.1 Lagja Uznove, Rajoni Nr.1.....	4
2.2 Fshati Duhanas.....	6
3. OBJEKTIVI:.....	7
3.1 Detyrat:.....	7
4. TE DHENAT PER PROJEKTIN:.....	7
4.1 Kërkesat Që Duhet Të Zgjidhë Projekti:.....	7
5. TE DHENAT KRYESORE: .....	8
5.1 Dorezimi i dokumentacionit .....	9



**OBJEKTI: NDERTMI I RRJETIT TE RI TE KANALIZIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA TE LAGJES UZNOV, RAJONI NR.1 DHE FSHATI DUHANAS, BASHKIA BERAT**

VENDNDODHJA: Bashkia BERAT

**1. QELLIMI:**

Investimet në objektin: "Ndertmi I Rrjetit Te Ri Te Kanalizimeve Te Ujrave Te Zeza Te Lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 Dhe Fshati Duhanas, Bashkia Berat" do te kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, siç është vazhdimësia e shërbimit dhe ne uljen e shpenzimeve operative të Shoqerise Ujesjelles Kanalizime Berat. Bashkia Berat synon te hartoje projekt – zbatimin per nderhyrjet ne rrjetin e ujrave te zeza te Lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 dhe fshatit Duhanas. Gjendja aktuale e rrjetit KUZ ne lagjen Uznov, rajoni Nr.1 pjesa Veriore mbi rrugen nacionale eshte tejte e amortizuar ndersa pjesa tjeter mungon, ndersa ne fshatin Duhanas mungon totalisht. Ndertmi I Rrjetit Te Ri Te Kanalizimeve Te Ujrave Te Zeza Te Lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 Dhe Fshati Duhanas, Bashkia Berat, do ti hape rruge kryerjes se nje sere investimesh infracruese. Pasi ne gjendjen aktuale bashkia e ka te pamundur te nderhyje pa perfunduar punimet e infrastruktures nentokesore.

Mbeshtetur ne strategjine e zhvillimit per Qytetin e Beratit, duke pare dhe zhvillimin e lagjes Uznov dhe konfiguracionit te terenit, eshte i mundur qe kolektori kryesore i kesaj zone duke marre parasyshe edhe zhvillimin e kesaj zone ne te ardhmen, te mblidhen ne nje pike dhe te transporton drejt impjantit te ujrave te zeza sipas planifikimit te Bashkise Berat.

Me planin e mesiperm i jepet zgjidhje perfundimtare problemit te ujrave te zeza lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 dhe fshatit Duhanas, duke siguruar nje rrjet ujrash te zeza teresisht funksional modern si dhe ne perputhje me standartet me te larta te kerkuar, gjithashtu ndahen perfudimisht ujrat e shiut nga ato te zeza ne perputhje me direktivat e Bashkimit Europian. Gjithashtu pasi te perfundoje investimi kostot e mirmbajtjes se shoqersie se ujesjelles kanalizime Berat do te reduktohen ndjeshem.

Gjendja e përgjithshme e rrjetit do të përmirësohet, kështu që do të zvogëlohet ndjeshëm numri i nyjeve në tubacion që do të prishen, ndaj do të zvogëlohen të gjitha kostot që lidhen me to.

*Ky investim duke patur parasysh edhe situatën problematike të shkaktuar prej virusit Covid -19 prej afro 1 viti merret një rëndësi jetike për shëndetin e banorëve të zonës.*

## **2. PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES:**


### **2.1 Lagja Uznove, Rajoni Nr.1**

Rrjeti egzistues në lagjen Uznove, rajoni Nr.1 është në gjendje të amortizuar dhe vende vende i demtuar, gjithashtu në pjesë të madhe të tij është i hapur duke u bërë problem infeksionesh për banorët. Ky rrjet është ndërtuar para shumë viteve me tubacion betoni të diametrave nga 200 mm në 500 mm. Ai sot shkarkon në kanalet e zonës duke shkaktuar vërtet problematike shumë të mëdha në funksionim dhe dëme të mëdha mjedisore siç ilustron edhe në fotot e mëposhtme.





Me poshe po paraqitet skematikisht harta e zones Uznov, Rajoni Nr.1:



Popullsia e lagjes Uznov, Rajoni Nr.1, Bashkia Berat eshte rreth 6400 banore. Gjate kohes se veres popullsia rritet ne krahasim me stinet e tjera si rezultat i ardhjes se popullise emigratore dhe ploteson numrin maksimal te saj.

Ky koeficient rritje eshte i justifikuar sepse perspektiva e zgjerimit te zones se banimit parashikohet te behet me vila individuale te cilat do te kene numur me te madh banoresh rezident dhe sezonale dhe norme me te larte ditore te perdorimit te ujit. Ne stinen e veres konsumi i ujit rritet ne krahasim me stinen e dimrit.

Konsumatore te tjere jane rreth 150 biznese dhe disa institucionet shteterore qe ndodhen ne kete zone, per te cilat do te llogariten nevojat per shkarkim ujrash te zeza.

## 2.2 Fshati Duhanas

Fashti Duhanas ka nje mungese totale te rjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza, kjo perben nje shqetesim te madh pasi ujrat e zeza derdhe ne ambjente te hapura duke sjelle nje rezik per jeten dhe shendetin e banoreve sidomos ne periudhen pandemike ku ndodhemi.

Fashti ndodhet i ndare ne tre zona te cilat shkarkojne ne ambjente te hapura ose me gropa skeptike duke shkaktuar deme te mbedha mjedisore. Me poshe po paraqitet skematikisht harta e zones se fashtit Duhanas, Bashkia Berat:



Popullsia e fshatit Duhanas, Bashkia Berat eshte rreth 2300 banore, 540 familje si dhe disa biznese.

### 3. OBJEKTIVI:

Objektivi i detyres se projektimit eshte hartimi i projektit te zbatimit per "Ndertmi I Rrjetit Te Ri Te Kanalizimeve Te Ujrave Te Zeza Te Lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 Dhe Fshati Duhanas, Bashkia Berat"

#### 3.1 Detyrat

Per realizimin e projektit projektuesit duhet te rishikojë te gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin qe duhet te hartojë per "Ndertmi I Rrjetit Te Ri Te Kanalizimeve Te Ujrave Te Zeza Te Lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 Dhe Fshati Duhanas, Bashkia Berat" sipas detyres se projektimit dhe te konsultohet me njesine e qeverisjes vendore Bashkia Berat dhe sh.a. Ujesjelles kanalizime Berat.

Cilesia e studim projektimit duhet te jete e tille qe te arrihet standarti i kerkuar dhe te plotesoje kushtet e projektimit.

### 4. TE DHENAT PER PROJEKTIN:

1. Popullsia aktuale Lagja Uznove 6400 banore dhe Fshati Duhanas 2300 banore.
2. Prespektiva e rjetit te kanalizimeve te parashikohet per 20-25 vjet.
3. Materiali i tubacionit te jete HDPE SN 8diametra te ndryshem .

#### 4.1 Kërkesat Që Duhet Të Zgjidhë Projekti:

Projekti i hartuar duhet të përmbajë :

1. Korografinë në shkallë 1 : 10.000 -1:25000
2. Përshkrimi i gjëndjes së trasesë
3. Hartimi i relievit topografik të zonës ku do të ndërhyhet (kordinata lokale, kuota absolute).
4. Planimetrinë e rrjetit ne shkallë sipas formatit te fletës së vizatimit dhe te jene te lexueshme
5. Profilin gjatësor ne shkallë sipas formatit te fletës së vizatimit dhe te jene te lexueshme

6. Profila tërthorë në shkallë 1:20.

7. Detaje të ndryshme në shkallë 1:50 .

8. Hollesite ndertimore te pusetave, detajet teknike te shtrimit te tubacioneve.

9. Relacioni teknik.

10. Llogaritjet hidraulike .

11. Llogaritjet konstruktive.

12. Preventivi i kryerjes së punimeve, duke u mbështetur në çmimet e Manualit të Çmimeve të vitit 2015 të shoqëruara me analizat përkatëse.

13. Specifikimet teknike të zbatimit të projektit per zerat e punimeve qe do te kryhen .

14. Planin e organizimit te punimeve dhe grafikun e kohezgjatjes se tyre duke e llogaritur ne baze te oreve te punes

15. Marrjen e masave te sigurimit teknik te punetoreve ashtu edhe te publikut.

16. Projekt preventivi të paraqitet në katër kopje dhe në formë dixhitale.

17. Raport i Vleresimit Mjedisor.

## 5. TE DHENAT KRYESORE:

Hartimi i projektit te objektit "Ndertmi I Rrjetit Te Ri Te Kanalizimeve Te Ujrave Te Zeza Te Lagjes Uznov, Rajoni Nr.1 Dhe Fshati Duhanas, Bashkia Berat", bazuar ne programin e investimeve.

### STANDARTET

-Standarte ne projektim.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektimin që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi duhet të rekomandojë dhe prezantimin e standarteve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si edhe të praktikave me të mira ndërkombëtare në projektin dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të realizueshmërisë me praktikën shqipëtare dhe limitimet për financimin e veprës.

- Standarte ne paraqitjen e dokumentacionit teknik.



Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për Planifikimin e Territorit", Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

Me anën e këtij raporti teknik të sqarohen investigimet e bëra nga projektuesi për gjendjen egzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit, llogaritjet përkatëse për mënyrën e furnizimit me ujë.

Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes dhe rehabilitimit të sistemit, specifikimet teknike për materialet si dhe proceset e punimeve që do të kryhen, vizatimet e nënobjekteve, që do të ndërtohen (planimetri, profila, prerje, hollësi ndërtimore, detaje teknike etj), si dhe volumet kryesore të punimeve dhe materialeve, makinerive e pajisjeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje për ndërtimin e këtij ujësjellësi dhe për zgjidhjen përfundimisht të problemit të furnizimit me ujë për sot dhe perspektive.

### 5.1 Dorezimi i dokumentacionit

Produkti	Nr. i kopjeve	Afati i dorëzimit
Faza I-VI e Projektit Dokumentat e projekt zbatimit përfshirë Vizatimet, Raportet, Grafikon e Punimeve, Specifikimet dhe Preventivin	4 shqip + kopje elektronike	30 dite pas fillimit të kontratës

#### Hartoi Detyren e Projektimit

Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

Ark Luciano Bojaxhiu  
Rolinda Veliu  
Erida Nasufi

(LAGJA UZNOVE)

## KOSTOJA E LLOGARITESHME X = 199'904'106 LEKE PA TVSH

Seksion III, Vepra Inxhinierike, neni 38, Grupi Tarifor II

Kostoja e llogaritëshme K1= 180'000'000 leke pa T.V.Sh.

me vlerë minimale (a) = 5.87% dhe vlerë maksimale (b) = 6.76%

Kostoja e llogaritëshme K2 = 200'000'000 leke pa T.V.Sh.

me vlerë minimale (c)= 5.57% dhe vlerë maksimale (d) = 6.45%

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave a dhe b sipas formulës:

$$H1 = a + (0 \div 1) \times (b - a)$$

$$H1 \text{ min} = a + 0 \times (b - a) = a = 5.87\% \times 180,000,000 = 10,566,000 \text{ leke}$$

$$H1 \text{ max} = a + 1 \times (b - a) = b = 6.76\% \times 180,000,000 = 12,168,000 \text{ leke}$$

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave c dhe d sipas formulës:

$$H2 = c + (0 \div 1) \times (d - c)$$

$$H2 \text{ min} = c + 0 \times (d - c) = c = 5.57\% \times 200,000,000 = 11,140,000 \text{ leke}$$

$$H2 \text{ max} = c + 1 \times (d - c) = d = 6.45\% \times 200,000,000 = 12,900,000 \text{ leke}$$

Llogarisim diferencën e kostove të llogaritëshme reale

$$X - K1 = D1 = 199,904,106 - 180,000,000 = 19,904,106 \text{ leke}$$

Llogarisim diferencën mes dy kostove

$$K2 - K1 = D2 = 200,000,000 - 180,000,000 = 20,000,000 \text{ leke}$$

Llogarisim diferencën minimale/maksimale:

$$H2 - H1 = D3 \text{ min} = 11,140,000 - 10,566,000 = 574,000 \text{ leke}$$

$$H2 - H1 = D3 \text{ max} = 12,900,000 - 12,168,000 = 732,000 \text{ leke}$$

Formula e interpolimit për tarifën minimale, do të jetë:

$$H1 \text{ min} + (D3 \text{ min} \times D1) / D2 = 10,566,000 + (574,000 \times 19,904,106) / 20,000,000 = 11,137,248 \text{ leke}$$

Formula e interpolimit për tarifën maksimale, do të jetë:

$$H1 \text{ max} + (D3 \text{ max} \times D1) / D2 = 12,168,000 + (732,000 \times 19,904,106) / 20,000,000 = 12,896,490 \text{ leke}$$

Vlera minimale të të gjitha fazave të percaktuara në nenin 36 të VKM 354 është

11,137,248 leke pa tvsh, i referohemi fazave nga I-VII Projekti do të kemi:

$$11,137,248 \times 72\% = 8,018,818.45 \text{ leke vlera minimale i projektit të zbatimit.}$$

Vlera maksimale të të gjitha fazave të percaktuara në nenin 36 të VKM 354 është

12,896,490 leke pa tvsh, i referohemi fazave nga I-VII Projekti do të kemi:

$$12,896,490 \times 72\% = 9,285,473 \text{ leke vlera maksimale (fondi Limit) i projektit të zbatimit.}$$



(Fshati Dumanas)

**Kostoja e llogaritëshme X = 98'158'293 leke pa tvsh**

Seksion III, Vepra Inxhinierike, neni 38, Grupi Tarifor III

Kostoja e llogaritëshme K1= 90,000,000 leke pa T.V.Sh.

me vlerë minimale (a) = 8.78% dhe vlerë maksimale (b) = 9.73%

Kostoja e llogaritëshme K2 = 100,000,000 leke pa T.V.Sh.

me vlerë minimale (c)= 8.47% dhe vlerë maksimale (d) = 9.41%

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave a dhe b sipas formulës:

$$H1 = a + (0 \div 1) \times (b - a)$$

$$H1 \text{ min} = a + 0 \times (b - a) = a = 8.78 \% \times 90'000'000 = 7,902,000 \text{ leke}$$

$$H1 \text{ max} = a + 1 \times (b - a) = b = 9.73 \% \times 90'000'000 = 8,757,000 \text{ leke}$$

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave c dhe d sipas formulës:

$$H2 = c + (0 \div 1) \times (d - c)$$

$$H2 \text{ min} = c + 0 \times (d - c) = c = 8.47 \% \times 100,000,000 = 8,470,000 \text{ leke}$$

$$H2 \text{ max} = c + 1 \times (d - c) = d = 9.41 \% \times 100,000,000 = 9,410,000 \text{ leke}$$

Llogarisim diferencën e kostove të llogaritëshme reale

$$X - K1 = D1 = 97,244,500 - 90,000,000 = 7,244,500 \text{ leke}$$

Llogarisim diferencën mes dy kostove

$$K2 - K1 = D2 = 100,000,000 - 90,000,000 = 10,000,000 \text{ leke}$$

Llogarisim diferencën minimale/maksimale:

$$H2 - H1 = D3 \text{ min} = 8,470,000 - 7,902,000 = 568,000 \text{ leke}$$

$$H2 - H1 = D3 \text{ max} = 9,410,000 - 8,757,000 = 653,000 \text{ leke}$$

Formula e interpolimit për tarifën minimale, do të jetë:

$$H1 \text{ min} + (D3 \text{ min} \times D1) / D2 = 7,902,000 + (568,000 \times 7,244,500) / 10,000,000 = 8,313,488 \text{ leke}$$

Formula e interpolimit për tarifën maksimale, do të jetë:

$$H1 \text{ max} + (D3 \text{ max} \times D1) / D2 = 8,757,000 + (653,000 \times 7,244,500) / 10,000,000 = 9,230,066 \text{ leke}$$

Vlera minimale të të gjitha fazave të percaktuara në nenin 36 të VKM 354 është

8,313,488 leke pa tvsh, i referohemi fazave nga I-VII Projekti do të kemi:

$$8,313,488 \times 72\% = 5,985,711.07 \text{ leke vlera minimale i projektit të zbatimit.}$$

Vlera maksimale të të gjitha fazave të percaktuara në nenin 36 të VKM 354 është

9,230,066 leke pa tvsh, i referohemi fazave nga I-VII Projekti do të kemi:

9,230,066 x 72% = 6,645,647 leke vlera maksimale (fondi Limit) i projektit te zbatimit.



**Fondi limit i Projektit te zbatimit te objektit eshte:**

**9,285,473 + 6,645,647 = 15,931,120 leke pa t.v.sh. ose 19'117'344 leke me t.v.sh.**